



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIMAL
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

Nr. 1284/Prot.
17

Urë Vajgurore, më 16.11. 2022

VENDIM

Nr. 2 datë 16.11. 2022

PËR

**AUTORIZIMIN E ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË AKSIONARE
UJESJELLËS-KANALIZIME DIMAL PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES
PËR TRANSFERIM VEPRIMTARIE DHE ÇDO AKTI TË NEVOJSHËM
KONTRAKTOR ME QËLLIM TRANSFERIM VEPRIMTARIE**

Në mbështetje të nenit 135 dhe 158, pika 3, gërma b) të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", *ndryshuar*, nenit 12 gërma c), ç) dhe d) dhe neni 20 gërma d), ë) dhe i) të Statutit të Shoqërisë UK Dimal SH.A., të Kreut II, pika 8 të VKM Nr.302 datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", të Marrëveshjes për krijimin e shoqërisë Rajonale Ujisjellës Kanalizimeve, Rajoni Berat SH.A., të lidhur midis Bashkive Berat, Kuçovë, Skrapar, Poliçan, Dimal dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë datë 28.09.2022, si dhe të pikës 2 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Dimal Nr. 56 datë 17.10.2022 Miratimin e Marrëveshjes dhe pjesëmarrjen e Bashkisë Dimal në Shoqërinë Ujësjellës Knalizimeve, Rajoni Berat SH.A., me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me uji të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura", Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve,

VENDOSI:

1. Të autorizojë administratorin e Shoqërisë U.K Dimal SH.A., z. Petref Sula të përfaqësojë Shoqërinë Aksionare Ujësjellës-Kanalizime Dimal, e transferuesit, dhe të nënshkruajë aktin e transferimit (Kontratën) noteriale me qëllim transferimin e plotë të veprimtarisë që ka tashmë Shoqëria Aksionare Ujësjellës-Kanalizime Dimal, për tek shoqëria e re Subjekt me Kopetenca të Përbashkëta Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve Berat, në cilësinë e marrësit të transferimit.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE U.K DIMAL
KRYETAR I BASHKISË DIMAL**

JULIANA MEMAJ



Adresa : Rruga "Dimal"
Lagjia "18 Tetori", Ura Vajgurore

Telefon: 035536122468
e-mail: bashkia@bashkiadimal.gov.al